



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Më 19 shkurt, Kryetarja e Dhomave të Specializuara (DHSK), gjykatëse Ekaterina Trendafilova, vendosi modifikimin e dënimeve të z. Sabit Januzi dhe z. Ismet Bahtijari dhe mundësoi lirimin e tyre më 21 shkurt 2025, me kushtet e përcaktuara në vendimet përkatëse. Këto kushte do të mbeten në fuqi për pjesën e mbetur të dënimit me dy vjet që iu shqiptua të akuzuarve pasi miratimit nga Trupi Gjykses të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë me Prokuroren e Specializuar më 4 shkurt 2025. Z. Januzi dhe z. Bahtijari pranuan fajësinë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe frikësim gjatë procesit penal.

Kur personi i dënuar ka vuajtur dy të tretat e dënimit, Kryetarja e Dhomave të Specializuara mund të shqyrtojë uljen, modifikimin ose ndryshimin e dënimit. Z. Januzi dhe z. Bahtijari i kryen dy të tretat e dënimit më 5 shkurt 2025.

Kryetarja Trendafilova rikujtoi se veprat penale për të cilat z. Januzi dhe z. Bahtijari u shpallën fajtorë ishin të rënda, duke pasur parasysh pasojat që ka frikësimi i dëshmitarëve për administrimin e drejtësisë.

Në çështjen gjyqësore të *Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit* për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, më 24 shkurt, Trupi Gjykses autorizoi Prokuroren të vazhdonte që provat e kërkuara nga njëri prej ekipeve të Mbrojtjes t'i nxirrte edhe për ekipet e tjera, sikurse është praktika e deritanishme. Trupi Gjykses gjykon se nxjerrja në kohë e materialit që Prokuroria synon të përdorë gjatë rimarrjes në pyetje siguron që Mbrojtja të njoftohet mjaftueshëm në kohë për materialin, pavarësisht se në cilën rregull konkrete bazohet nxjerrja e tij.

Më 26 shkurt, Trupi Gjykses miratoi pjesërisht pranimin e disa provave materiale lidhur me organizimin e UÇK-së në zonën e Drenicës bazuar në autenticitetin dhe relevancën e tyre, dhe duke marrë parasysh konstatimin e Trupit Gjykses se pranimi i këtyre dokumenteve si prova nuk i shkakton dëm Mbrojtjes. Trupi Gjykses hodhi poshtë kërkesën e Prokurores lidhur me prova materiale që, sipas mendimit të Trupit Gjykses, nuk ishin autentike.

Më 21 shkurt, Trupi Gjykses miratoi pjesërisht një mocion të ngjashëm të Prokurores për prova në lidhje me zonën e Llapit dhe urdhëroi Prokuroren të ndryshonte listën e provave materiale jo më vonë se të premtën, 28 shkurt.





Më 26 shkurt, Trupi Gjykses hodhi poshtë një kërkesë të përbashkët të Mbrojtjes për marrjen e masave për të siguruar që paanësia e procesit të jetë e dukshme dhe të shmanget dëmi ndaj Mbrojtjes. Trupi Gjykses vuri në dukje se prej tij nuk mund të pritet të shqyrtojë pretendime abstrakte, që nuk janë as të faktuara, as të hollësishme, dhe theksoi se Mbrojtja nuk kundërshtoi asnjë vendim të Trupit Gjykses, as nuk ngriti shqetësime për anshmërinë, lidhur me pyetjet e bëra nga Trupi Gjykses.

Trupi Gjykses vuri në dukje më tej se Rregullorja nuk përcakton se sa kohë zgjasin pyetjet që Trupi Gjykses i bën dëshmitarit dhe theksoi se në shumë sisteme juridike pyetjet më të shumta bëhen nga gjykatësit. Trupi Gjykses theksoi se Mbrojtja nuk ka evidentuar asnjë pyetje që Trupi Gjykses i bëri dëshmitarëve të përmendur në mocionin e Mbrojtjes, që nuk ishte relevante apo nuk lidhej me kërkimin e të vërtetës.

Trupi Gjykses theksoi se pyetjet e tij mund të çojnë në prova inkriminuese ose shfajësuese, në aspekte për t'u sqaruar, apo që lidhen me besueshmërinë e një dëshmitari. Pyetjet bëhen për të marrë dëshmi që Trupi Gjykses i gjykon relevante dhe të domosdoshme për të përmbushur detyrimin e vet për zbulimin e së vërtetës.

Në lidhje me pretendimin se u bënë pyetje sugjестive, Trupi Gjykses vuri në dukje se i vetmi shembull që dha Mbrojtja për këtë pretendim lidhej me një dëshmitar, të cilin Trupi Gjykses e kujtoi disa herë që t'u përgjigjej pyetjeve dhe, në këtë rast, Trupi Gjykses përdori pyetje sugjестive që ta mbante dëshmitari të fokusuar në pyetjen që po bëhej.

Trupi Gjykses rikujtoi se është detyrë e tij të vlerësojë besueshmërinë e dëshmitarëve dhe mbështetshmërinë në dëshmitë e tyre. Kufizimi paraprakisht i pyetjeve nga Trupi Gjykses do të ishte ndërhyrje e rëndë në rolin e Trupit Gjykses si zbulues neutral i fakteve.

Seanca e ardhshme në këtë çështje gjyqësore është caktuar për të hënë, 17 mars, në orën 09:00 paradite.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët* në lidhje me pretendime për ndikim ndaj dëshmitarëve, më 25 shkurt, Paneli i Apelit miratoi kërkesën e z. Smakaj dhe z. Fazliu për zgjatje të afatit për t'u përgjigjur Apelit të Prokurorisë kundër Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës, dhe autorizoi ekipet e Mbrojtjes të dy të akuzuarve që të dorëzojnë përgjigje, nëse do të kenë, deri të hënë, 3 mars 2025. Trupi Gjykses gjithashtu urdhëroi riklasifikimin e kërkesave të tyre si publike.

Paneli i Apelit vuri në dukje se aspektet që apelohej mund të ndikojnë ndjeshëm në rezultatin e procesit dhe, rrjedhimisht, është në interes të drejtësisë që mbrojtësve të sapocaktuar të z. Smakaj dhe z. Fazliu t'u jepet kohë të njihen me çështjen gjyqësore, në mënyrë që t'i përgjigjen siç duhet apelit të paraqitur.

Më 21 shkurt, Gjykatësja e Procedurës Paraprake në këtë çështje gjyqësore miratoi një kërkesë të përbashkët për të zgjatur më tej afatin për dorëzim të mocioneve paraprake. Këto mocione mund të jenë, për shembull,





kundërshtime ndaj juridiksionit të Dhomave të Specializuara ose pretendime për mangësi në aktakuzë. Vendimi u bazua në faktin se Paneli i Apelit nuk ka marrë ende vendim mbi Apelin e Prokurorisë kundër Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës. Gjykatësja e Procedurës Paraprake caktoi afatin e ri prej 21 ditësh pas lëshimit të vendimit nga Paneli i Apelit, në qoftë se Paneli i Apelit do të konfirmojë në tërësi Vendimin mbi Konfirmimin e Aktakuzës. Në qoftë se Paneli i Apelit do të vendosë ndryshe, Gjykatësja e Procedurës Paraprake do të lëshojë urdhër të ri për datat dhe afatet.

Në 25 shkurt, Paneli i Gjykatës Supreme hodhi poshtë në tërësi kërkesat e Salih Mustafës dhe të Prokurorisë për mbrojtje të ligjshmërisë. Ndërsa z. Mustafa kërkoi uljen e dënimit të njëzuar me 15 vjet burgim, Prokuroria pretendon se me dhënien e dënimit të ri me 15 vjet, Paneli i Apelit kishte shkelur konsiderueshëm procedurat, sepse nuk dha mendim të arsyetuar.

Gjykata Supreme vuri në dukje se në Vendimin e ri për Përcaktimin e Dënimit, Paneli i Apelit iu përmbajt specifikisht konstatimeve në Vendimin e mëparshëm të Gjykatës Supreme, shkallëzimit të dënimit të identifikuar aty, si dhe jurisprudencës ndërkombëtare përkatëse. Paneli rikujtoi më tej se rrethanat e krimeve për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor, ndër të cilat vrasja e paligjshme, u morën parasysh gjerësisht nga Trupi Gjykues, dhe dy herë nga Paneli i Apelit.

Rrjedhimisht, Paneli është i mendimit se z. Mustafa nuk ka demonstruar se si Paneli i Apelit mund të kishte vendosur dënim tjetër për të, dhe konstatoi se ai nuk kishte evidentuar se si dënimi me 15 vjet burgim përbën shkelje të së drejtës penale. Gjykata Supreme konstatoi gjithashtu se Prokuroria nuk demonstroi se si Paneli i Apelit nuk iu përmbajt Vendimit të Gjykatës Supreme dhe vëren se Paneli i Apelit e arsyetoi gjerësisht vendimin e vet dhe iu referua udhëzimeve që iu dhanë në lidhje me të.

Më 21 shkurt, Gjykatësi i Vetëm që mbikëqyr zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim në këtë çështje gjyqësore urdhëroi Mbrojtësin e Viktimave dhe Administratoren të dorëzojnë versionet e redaktuara publike të disa parashtrimeve që lidhen me Urdhrin për Zhdëmtim; të bëjnë parashtrime me shkrim nëse mendojnë se disa prej tyre nuk duhet të bëhen publike; si dhe të bëjnë me dije nëse, dhe kur, parashohin që do të jenë të mundshme versionet e redaktuara publike të atyre parashtrimeve.

Pyetjet e bëra

Në përgjigje të pyetjes se një gazetari, zëdhënësi konfirmoi se në një parashtrim që u bë publik rrëzohej kërkesa e z. Thaçi për një vizitë nën përcjellje për arsye humanitare, për shkak se z. Thaçi nuk ka demonstruar ekzistencën e arsyeve bindëse, të jashtëzakonshme dhe humanitare që do të përligjin lirin e përkohshëm të tij. Zëdhënësi e referoi gazetarin në parashtrimin përkatës për arsyetim më të hollësishëm.

